

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Inside Story/ Video tronditëse, vetura i pret rrugën motorit dhe... Skandali me ekspertizat që bënë viktimën fajtor
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/16/inside-story-video-tronditese-vetura-i-pret-rrugen-motorit-dhe-skandali-me-ekspertizat-qe-bene-viktimen-fajtor/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 19:27:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	16 shtator 2026, 19:20:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 16 shtator 2026, 19:19:00 UTC → 16 shtator 2026, 19:21:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	60862288e8ae6ff265e533af80d63d0bdc2667d942642b9077b3f34ffaa520d2
TEKSTI	b23b9004a287aac2d76ec51533ff1432df40bb89bc64cfbff4940b7d8e43d6b5
PAMJA	449b7d10a0001c729b3d3dcd4e686bc5aab522072e1b91c1d6a73ee0b888558c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	18bea354b19426cc42fce2a6dde346efdc00dbf60323f7e750d0f7d87f620bf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a2ff65fb1ec0abbd824a4690f8572392275823afe6c37713ebc7a42874eb87f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/18bea354b19426cc42fce2a6dde346efdc00dbf60323f7e750d0f7d87f620bf>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

INSIDE STORY KRYESORE TË FUNDIT

Inside Story/ Video tronditëse, vetura i pret rrugën motorit dhe... Skandali me ekspertizat që bënë viktimën fajtor

16/09/2026 21:20



Në çdo aksident rrugor, sekondat e para janë vendimtare. Është momenti kur ngjarja ende "jeton" në terren: në pozicionin e mjeteve, gjurmët e frenimit, dëmtimet dhe çdo detaj që më pas kthehet në provë.

Të parët që mbërrijnë janë patrullat e policisë, të cilat sigurojnë zonën dhe japin ndihmën e parë. Kur aksidenti ka pasojë të rënda, nis edhe faza hetimore: oficeri i policisë gjyqësore, eksperti kriminalistik, ai autoteknik, dhe prokurori që drejton procesin.

Por, në shumë raste, prokurori nuk shkon në vendngjarje, duke lënë OPGJ-në të plotësojë procesverbalin.

"Duke qenë prokurori në vendngjarje nuk ngushtohet dhe nuk merret vetëm me element shumë të vegjël dhe shumë të ngushtë të aksidentit, por e zgjeron gamën e hetimit, për të nxjerrë përgjegjësinë edhe personat që përgjigjen për rrugën, ose më saktë entin pronar të rrugës, ku në rastin konkret mund të jetë njëherë drejtoria e rrugëve, njëherë bashkia, në varësi të faktit ku ka ndodhur aksidenti. Dhe në rast se hetimet kryhen të thella dhe të plota shmanget dhe evitohen aksidentet e tjera", u shpreh ish-prokuror, Eugen Beci.

"Procesverbali, i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga policia rrugore që shkon në vendngjarje është elementi kryesor nga e cila bazohet pastaj zgjidhja e asaj ngjarjeje që ka ndodhur në rrugë. Fatkeqësisht ne e shohim në rrugë që ka shumë mangësi në këqyrjen e vendit të ngjarjes. Ne bëjmë këqyrje nga këto baziket ku caktohet një pikë referimi, sa metra është njëra gomë sa metra është një gjurmë në rrugë", u shpreh Gedeon Dudushi

Në teori, kjo është faza ku ndërtohet e vërteta e aksidentit. Por në praktikë krijohen hapësira që ngrenë pikëpyetje. Akoma më keq, përgjegjësitë lihen mënjanë duke inkurajuar abuzuesit e rëndë të rrugës që ia hedhin lehtë.

Nga analiza e disa vendimeve gjyqësore dhe dosjeve hetimore, rezulton se në disa raste dokumentimi i vendngjarjes nuk pasqyron plotësisht realitetin e terrenit.

"Tani akti i ekspertimit sipas ligjit është një provë si të gjitha provat e tjera që mbledhen në një dosje, dhe thuhet se nuk ka një vlerë determinante. Por në fakt ajo është vlera determinante. Sepse çfarë do të thotë një gjyqtar apo një prokuror, kur një ekspert apo një grup ekspertësh përcaktojnë që fajësia është e këtij personi", u shpreh Gedeon Dudushi.

"Gjykimet e çështjeve të aksidenteve rrugore, përbëjnë çështjet më të vështira për gjykatën pikërisht për shkak të pasojave njerëzore që kanë këto raste. Nga njëra anë është humbja e jetës së personit dhe dhimbja e familjarëve që duhet thënë nuk mund të zhbëhet tërësisht në asnjë vendim gjyqësor, por nga ana tjetër gjykata ka detyrimin që të vlerësojë çështjen me objektivitet duke u bazuar në ligjin e zbatueshëm", u shpreh

I Kryesore



Ekskluzive/ "Jam i rënduar psikologjikisht, Thačin tani do e kem më shumë mik", Majko i përbotur: Shqipëria e Kosova të shtrëngojnë dhëmbët dhe...

20:21

Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së. Prishtina "ngrihet në këmbë" për Thačin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, protesta para institucioneve

19:35

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!

19:10

"E respektojmë aktgjykimin e Dhomave të Specializuara"/ Reagon SHBA pas vendimit të Hagës: Të shmanget retorika nxitëse

15:47

"Topin e kam unë" së shpejti në Top Channel! Apliko tani në top-channel.tv

16:40

I Më të lexuarat

Dënimi me 81 vite burg i ish-liderëve të UÇK, Vuçiq del në konferencë dhe ankohet: Nuk janë dënuar për krime kundër njerëzimit

Nuk kënaqet me 81 vite burg për ish-krerët e UÇK, Prokurorja e Specializuar e Hagës: Do kërkojmë në Apel dënim edhe për krimet kundër njerëzimit

Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së. Prishtina "ngrihet në këmbë" për Thačin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, protesta para institucioneve

"A ka rrezik të vdesë në burg?" / Milaim Zeka shpërthen në lot, tregon komentën e vajzës për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së

Gjykata speciale në Hagë dënon me 81 vite në total për ish-liderët e UÇK, protestë masive në Prishtinë

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!

Seanca për ish-krerët e UÇK-së në Hagë, gjykata dënon me 25 vite burg Hashim Thačin

Nuk mund të luajë më me Shqipërinë, sulmuesi i talentuar grumbullohet nga Jurgen Klopp

"U vërtetua arrestimi i paligjshëm i së paku

gjyqtari, Xhuljo Doku.

Por, problemi më i ndjeshëm në hetimin e vdekjeve nga aksidentet shfaqet më vonë: kur e njëjta ngjarje analizohet nga ekspertë të ndryshëm dhe prodhon përfundime të ndryshme.

Në disa dosje, mbi të njëjtat prova kryhen disa ekspertiza që nuk përputhen me njëra-tjetrën, duke ndryshuar edhe përgjegjësinë e drejtuesve të mjeteve.

Një rast konkret e ilustron qartë këtë problematikë.

Më 19 gusht të vitit 2025 u përfshinë në një aksident Albert Agaj, i cili drejtonte një Ford Fiesta, dhe një motor BMË me drejtues shtetasin Gazment Gropa.

Sipas dosjes hetimore, në ekspertizën e parë autoteknike përfundimi është i prerë: drejtuesi i Ford Fiesta nuk ka kryer asnjë shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor.

Në akt thuhet: "Nga Albert Agaj nuk ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor."

Përkundrazi, përgjegjësia i atribuohet drejtuesit të motorit, i cili sipas ekspertëve ka qarkulluar me shpejtësi rreth 110–120 km/h, nuk ka respektuar distancën e sigurisë dhe nuk ka mundur të kontrollojë mjetin në kohë.

Në këtë fazë, tabloja është e qartë: motori paraqitet si shkaktari i aksidentit.

Por situata ndryshon rrënjësisht më vonë.

Familjarët kundërshtojnë ekspertizën dhe dorëzojnë në prokurori pamje filmike të aksidentit. Ky element rezulton vendimtar, pasi sjell një rishikim të plotë të ngjarjes.

Në ekspertizën e dytë, nga analiza e videos, del një fakt që nuk ishte evidentuar më parë: Ford Fiesta nuk qëndron në korsinë e tij, por kryen një manovër kthimi majtas për të hyrë në një rrugë dytësore, në momentin kur motori po afrohej.

Kjo ndryshon krejt interpretimin e aksidentit...

"Përsa i përket kamerave pastaj është një nga elementët më të rëndësishëm që duhet të ndodhë që policia duhet të ketë prioritarë marrjen e kamerave, dhe të marri kamerën jo vetëm në momentin e ndodhjes së aksidentit, por në një plan edhe më të gjerë se si është sjellje e këtij drejtuesi mjeti, edhe në një spektër më të gjerë. Sepse nga ajo ti kupton edhe sesi ai ka vazhduar të lëvizë në rrugë", u shpreh gjyqtari, Xhuljo Doku.

Ekspertiza e dytë arrin në përfundimin se drejtuesi i Ford Fiesta ka kryer disa shkelje të rënda: ka shkelur sinjalistikën horizontale, ka kryer manovër të ndaluar dhe nuk i ka dhënë përparësi mjeteve që vijnë përballë. Pra, nga një drejtues pa shkelje në ekspertizën e parë, ai rezulton shkaktari i aksidentit.

Më tej, ekspertët analizojnë dinamikën në sekonda: nga hyrja në korsinë e kundërt deri në përplasje kalojnë vetëm rreth 1.5 sekonda, ndërsa motori ndodhej afërsisht 50 metra larg.

Në llogaritjet e frenimit, ata theksojnë se edhe nëse motori do të kishte qenë brenda kufijve të shpejtësisë, distanca nuk do të mjaftonte për shmangien e përplasjes.

Kjo bëhet baza mbi të cilën prokuroria arrin në përfundimin se përgjegjësia bie mbi drejtuesin e Ford Fiesta, pasi manovra e tij është faktori vendimtar i aksidentit.

Ky rast ngre një problem më të madh se vetë ngjarja.

Si është e mundur që mbi të njëjtat prova, të njëjtin vend aksidenti dhe të njëjtat mjete, të arrihen dy përfundime krejtësisht të kundërta?

Në një version, një drejtues rezulton i pafajshëm. Në tjetrin, i njëjti drejtues del shkaktar i aksidentit fatal.

A munguan prova në momentin e parë? A u dokumentua në mënyrë të paplotë vendngjarja? Apo pamjet filmike zbuluan elemente që ndryshuan interpretimin e ngjarjes? Praktakisht, ekspertiza përcakton fajtorin e për pasojë, përgjegjësinë penale. Nisur nga praktikat nëpër gjykata, ekzistenca e disa akteve që rrëzojnë njëri tjetrin për të njëjtën ngjarje, është tregues i qartë i një skeme të madhe korruptive që përdoret nga vrasësit në timon për të ikur përgjegjësi...

"Ajo që qëndon momentalisht, është mungesa e theksuar e ekspertëve profesionistë të licencuar që të jenë më të shumtë në numër dhe aktin e akcizimit të bëjnë në rast

385 personave"/ Trupi gjykues: Të ndaluarit u rrahën dhe iu shkaktuan vuajtje psikologjike

Burg për ish-krerët e UÇK-së, Milaim Zeka: E dija që para 3 ditësh se do kishte vendim të rëndë, ja sinjalet

...nëse do të jenë më të shpejtë në hetim, dhe kështu e shpejtojmë të zgjedhjen në qytet, mos ta bëjnë në periudhën hetimore, sepse do të kishte një reagim më të shpejtë, mund të kishim një fajësi direkte, mund të kishim një nderim të rrugës nga ekspertë të specializuar", u shpreh avokati Bledar Meminaj.

"Për familjarët e viktimave të aksidenteve rrugore humbja është e madhe dhe e parikuperueshme, prandaj kërkohet që hetimi paraparak dhe gjykimi penal për këto raste të jetë i shpejtë dhe me efektivitet, në mënyrë që drejtësia për ngjarje të tilla të rënda të mos vonoj", u shpreh gjyqtari, Xhuljo Doku.


Top Channel

I Inside Story »



Inside Story/ Video ekskluzive nga momentet e tmerrit, kamioni zë poshtë kalimtarin në rrugë, shoferi largohet dhe...

16/09 21:27



Inside Story/ "Para se të jem eskortë jam nënë e një vajze të mitur që...", rrëfimi pa doreza i vajzës kolumbiane

24/06 22:20



Inside Story/ "Alo, policia, i pagova për seks por refuzoi!" Eskorta: Ishte i pistë... Si u zbulua çerdhja e prostitutave latine

24/06 21:59



Inside Story/ Vëllai u arrestua për shfrytëzimin e motrës, e reja: Ndodhej rastësisht në banesën që ndaja me eskortat e tjera...

24/06 21:46



Inside Story/ Rrëfihet 20-vjeçarja nga Kolumbia: Erdha për punë normale por... kam klientë policë dhe zyrtarë

24/06 21:27



"Turizmi" i eskortave, Inside Story heton rrjetin e prostitucionit me shtetase të huaja në Shqipëri

24/06 13:22

I Kryesore »



Inside Story/ Video ekskluzive nga momentet e tmerrit,



Ekskluzive/ "Jam i rënduar psikologjikisht, Thaçin tani do e



"Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi në kapitujt më të ndritur

kamioni zë poshtë kalimtarin në rrugë, shoferi largohet dhe...

16/09 21:27



Gjykata e Lartë kundër projektligjit për pagat e magistratëve: Kuvendi të mos e votojë

16/09 19:41

kem më shumë mik", Majko i përletur: Shqipëria e Kosova të shtrëngojnë dhëmbët dhe...

16/09 20:21



Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së. Prishtina "ngrihet në këmbë" për Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, protesta para institucioneve

16/09 19:35

të historisë sonë kombëtare", ish-presidenti Meidani: Në ç'emër flet kjo gjykatë kur populli i Kosovës proteston?

16/09 19:53



Vendimi i Hagës për liderët e UÇK-së/ Protestuesit gjuajnë me gurë godinën qeveritare në Prishtinë, arrestohet një prej tyre. Tubim edhe para Parlamentit

16/09 19:25

Na ndiqni:



I Video »



Top News – Asnjë rrjet social para moshës 13 vjeç/ Von der Leyen prezanton planin, preken dhe 15-vjeçarët



Top News- Grenell thirrje të fortë Kurtit: Të shpërbëhet specialja, vendimi politik



Top Channel/81 vite burg për liderët e UÇK, Thaçi dhe Krasniqi 25 vite, Veseli 18 vite dhe Selimi 13



Top News- Plumba avokatit në Durrës, autori ja mbath...panik në zonën e Vollgës



Top Channel/ "Jam i rënduar", Majko në lot pas vendimit të Hagës: Të shtrëngojmë dhëmbët tani dhe..



Top News- 'Lufta e UÇK-së ishte për liri'/ Ali Ahmeti thirrje për unitet: Mos bini në grackë

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Topin e kam unë – Apliko tani!
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.